

## KONTRIBUTI I TARIKATEVE ISLAME NË KOMITETIN “MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS”

Mbarimi i Luftës së Parë Botërore shtroi para popullit shqiptar problemin e ekzistencës së shtetit të pavarur shqiptar, demokratizimin e tij, çlirimin e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën mbretërinë serbo-kroate-slllovene. Lufta e Parë Botërore i shkaktoi Shqipërisë shumë plagë të rënda. Vendi pati shkatërrime dhe humbje të mëdha në njerëz, ndërsa ekonomia u dëmtua shumë rëndë. Shumë njerëz vdiqën jo vetëm nga zjarri i luftës, por edhe nga uria, si pasojë e dëmtimit të bujqësisë dhe të blegtorisë. Fshatra të tëra u dogjën dhe u shkretuan. Në këto kushte rritet lëvizja për të shpëtuar vendin nga copëtimi i ri dhe për bashkimin kombëtar<sup>1</sup>. Andaj një grup patriotësh vendosën që të angazhohen në lëvizjen për çlirim dhe bashkim kombëtar, me qëllim që ta rikthenin shpresën dhe vullnetin e popullsisë shqiptare brenda kufirit në Kosovë, për të mos u dorëzuar. Krahas kësaj, ata donin që të përcillnin mesazhin edhe një herë para fuqive europiane, se populli shqiptar nuk dorëzohet para të drejtës së tij për liri dhe pavarësi. Si rezultat i krijimit të rrethanave të tilla, ata u angazhuan që të krijonin një organizatë politike për t’iu paraprirë atyre situatave kritike e të ndërlikuara<sup>2</sup>. Më saktë, më 1 maj 1918, u themelua Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (MKK)<sup>3</sup>. Qëllimi kryesor i këtij Komiteti ishte që të vendoste një Shqipëri të pavarur, të përjashtuar nga çdo lloj protektorati, të shpëtonte Kosovën dhe ta bashkonte me Shqipërinë<sup>4</sup>.

1 *Arkivi Qendror Shqiptar* (më tej: *AQSH*), F. 426, D. 9, f. 13: Programi i Përgjithshëm i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”: Qemajl Morina, “*Kontributi i Hoxhë Kadri Prishtinës në mbrojtjen e tërësisë së tokave shqiptare*”, *Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe indentitetit kombëtar* (Konferencë shkencore), Tiranë, botoi: Bashkësia Islame e Kosovës, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë, 2013, f. 197.

2 Eqber Skëndi, “*Hoxhë Kadriu (Kadri Prishtina)*”, Prishtinë, 1992, f. 36.

3 “*Fjalor Enciklopedik Shqiptar 2*”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 1234.

4 “*Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar 1918-1920*” (Përmbledhje dokumentesh), vëllimi I, përgatitur nga Muin Çami dhe Hidajete Luga (Bejtja), Akademia e Shkencave: Instituti i Historisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të shtetit të RPSH-së, Tiranë, 1975, f. 76.

Synimi i Komitetit ishte që aktivitetin e vet ta shtrinte brenda dhe jashtë trevave të cilat mbetën nën sundimin e huaj, me qëllim mbrojtjen sidomos të popullit të Kosovës, i cili më së shumti përjetoi gjenocidin serb. Po ashtu, kërkohej kthimi i të gjitha trojeve të copëtuara, nën ombrellën e Shqipërisë natyrale. Lidhur me këtë, edhe Programi i Përgjithshëm i Komitetit, në nenin II të tij shprehej:

*“Kjo Shqipni ka me pasë njato kufi qi i përkasin gjeografikisht mba parimeve të Wilsonit, e të cilët kanë për t’u sigurue tui iu pshtet tdrejtave pamohushme të kombit shqiptar”<sup>5</sup>.*

Kjo synohej të arrihej përmes kryengritjes së armatosur dhe me anë të memorandumëve dhe botimeve të ndryshme, njëkohësisht përmes një fushate energjike kundër pushtuesit italian që kërkonte t’i impononte Shqipërisë një lloj protektorati<sup>6</sup>. Ajo gjithashtu kishte si qëllim edhe mbledhjen dhe dërgimin në kryesinë e organizatës të statistikave të popullsisë dhe të vendbanimeve të saj<sup>7</sup>, të protestave e promemorieve që u drejtoheshin përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha të kohës, personaliteteve shtetërore, njerëzve përparimtarë në vende të ndryshme<sup>8</sup>.

Krahas themeluesve dhe drejtuesve të organizatës, u angazhuan edhe anëtarët e tarikateve islame gjatë periudhës së ekzistencës së veprimtarisë së këtij organizimi të shquar politik shqiptar, ndër të cilët ishin: baba Qazim Bakalli nga tarikati bektashi, Aqif pashë Elbasani anëtar i tarikatit bektashi<sup>9</sup>, Beqir Vokshi anëtar i tarikatit rifa’i, Ibrahim Fehmiu i tarikatit rifa’i, Hamdi Zajmi me dy vëllezërit Shaban dhe Mehmet nga tarikati bektashi<sup>10</sup>. Gjatë zhvillimit dhe funksionimit të teqeve dhe tarikateve në trevat shqiptare ka pasur shehlerë, dervishë dhe anëtarë të tarikateve të cilët janë dëshmuar për veprimtarinë e tyre shoqërore, historike dhe kulturore. Veprimtaria e Komitetit në ngritjen dhe fuqizimin e lëvizjes kombëtare shqiptare duhet

5 Programi i Përgjithshëm i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, AQSH, F. 426, D. 9, f. 13.

6 Tahir Zaimi, *Lidhja e II e Prizrenit dhe lufia heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës*, Bruksel, 1964, f. 24.

7 *Statistika të popullatës së rrethit të Gjakovës më 1918*, AQSH, F. 426, V. 1918, D. 26, f. 4.

8 *Lista që personat e ndryshëm i dërguan Komitetit lidhur me masakrat e serbo-malazezëve ndaj popullsisë kosovare* (Dorëshkrime shqip), AQSH, F. 426, V. 1920, D. 11, f. 1; Muin Çami, *Mbi themelimin e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” dhe orientimin politik të tij*, Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (Përmbledhje kumtesash), Tiranë, botues: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë – Tiranë, Instituti i Historisë – Prishtinë, 2004, f. 2004, f. 48-50.

9 Robert Elsie, *Fjalori Historik i Shqipërisë*, Tiranë, “UEGEN”, 2011, f. 121.

10 Shkëlzen Zajmi dhe Blerim Zajmi, *Familja Zajmi mbi 250 vjet çerdhe e pendës, pushkës dhe atdhedashurisë*, Shoqata e intelektualëve “Jakova”, Gjakovë, 2010, f. 143.

parë si bashkëpunim midis shtresave të ndryshme të shoqërisë shqiptare në Kosovë si: intelektualë, tregtarë, punëtorë, zanatçinj, nxënës etj. Në këtë kuadër, hyjnë dhe duhen vlerësuar edhe pjesëtarët e tarikateve.

Për rolin e këtyre figurave historike në lëvizjen për çlirim e bashkim kombëtar, gjatë viteve 1918-1924, kanë shkruar shumë studiues seriozë, të cilët kanë trajtuar nga këndvështrime të ndryshme problemet e kohëzgjatjes së veprimtarisë së Komitetit MKK, evidentimin e tipareve të lëvizjes në segmente të caktuara të saj, përcaktimin e datave, vlerësimin e ngjarjeve e personaliteteve të veçanta<sup>11</sup>.

Përgjegjësitë që i vunë vetes pjesëtarët e tarikateve islame në këtë etapë, kushtëzoheshin nga faktorë të ndryshëm. Ata vendosën që të bëhen pjesë e degëve të Komitetit të Kosovës, qëllimi kryesor i të cilit ishte organizimi i qëndrësës së shqiptarëve kundër politikës shfarosëse dhe shkombëtarizuese të shovinistëve serbomëdhenj, pasi Beogradi i perceptonte shqiptarët dhe i konsideronte si elementë antishtetërorë në dy rrafshë, në atë kombëtar dhe fetar<sup>12</sup>. Andaj, pjesëtarët e tarikateve, duke qenë të vetëdijshëm se territori shqiptar vazhdimisht trajtohej konform interesave të fqinjëve dhe Fuqive të Mëdha, u pozicionuan në anën e Komitetit. Këtë ua mundësonte edhe shtrirja e madhe gjeografike që kishin. Përveç kësaj, gjatë gjithë aktivitetit të tyre ndër vite e shekuj, gjatë aktivitetit të tyre fetar e shoqëror, përvetësuan traditat, idetë dhe vlerat kulturore të popullsisë vendase. Kështu, ata u bënë njësh me popullin. Mes të tjerave, për t'u bërë më të pranueshëm te qytetarët, ata zbukuronin teqetë me forma të ndryshme artistike origjinale, ashtu siç përdorëshin edhe në mjediset e shtëpive të fshatrave apo të qyteteve ku ngrihej teqeja.

Detyrat e degëve të Komitetit ishin që të ndihmonin në sigurimin e ushqimit dhe banimit të kosovarëve që ishin brenda qarkut, të jepnin mendime dhe informacione mbi nevojën e përparimit të atdheut<sup>13</sup>. Andaj, kryetari i Komitetit MKK, duke qenë i vetëdijshëm se feja është një faktor i rëndësishëm në jetën sociale, e cila ndihmon në normalizimin e bashkëjetesës ndërnjerëzore, ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë e njeriut ndaj atdheut, përmes një shkrimi u drejtohet edhe prijësve fetarë: *“Çka po qëndroni porsì gurë të vorreve? A po e besoni se keni pse me jetue, kur*

11 Jani Sota, *Publikimet në Shqipëri për Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” dhe veprimtarët e tij, Kosova*, Prishtinë: Instituti i Historisë – Prishtinë, nr. 37/38, 2013, f. 262.

12 Emine Arifi-Bakalli, *Përpjekjet e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” për realizimin e të drejtave demokratike e kombëtare të shqiptarëve në Jugosllavi, Kosova*, Instituti i Historisë – Prishtinë, Nr. 22/23, 2003, f. 162.

13 *Rregullore të organizimit të përmvendshëm të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”*, Shkodër, më 24.1. 1921, *AQSH*, F. 426, V. 1921, D. 6, f. 2.

*nuk u prini sot atdheut, andaj prini popullit në flakë të luftës!*<sup>14</sup>. Me anë të kësaj letre, kryetari i Komitetit, hoxhë Kadri Prishtina, dëshironte që gjatë kësaj periudhe që po kalonte Kosova, ata (ulematë), përmes angazhimit të tyre, të ishin në ballë të problemeve politike, ushtarake e diplomatike. Kështu, intelektual i baba Qazim Bakalli, i cili gjatë Luftës së Parë Botërore punoi si mësues në shkollën e vjetër të Gjakovës, paralelisht merrej edhe me veprimtari atdhetare-politike si dhe ishte anëtar i degës së Komitetit MKK në Gjakovë.

Si dëshmi për angazhimin e tyre, kryetarit dhe sekretarit të Komitetit u vinin informacione të hollësishme dhe të sakta nga të gjitha anët e trojeve shqiptare, sikurse për veprimet e armiqve, po ashtu edhe për veprimet e degëve. Kështu p.sh., Bakalli, si anëtar i degës së Gjakovës, në një letër të datës 5.11.1919, informonte se numri i ushtrisë serbe në Kosovë nuk është i madh. Nga ana tjetër, Malësia zotëronte më tepër se 3000 pushkë, ndërkohë që numri i fishekëve ishte i vogël. Ai gjithashtu bën me dije se numri më i madh i armëve ndodhen nëpër fshatra dhe shpreh besimin se *“me një organizim të mirë, serbët nuk do të mund të rrezikojnë para forcave shqiptare”*<sup>15</sup>. Po ashtu, baba Qazim Bakalli, më 7.11. 1919, informon Komitetin se në Gjakovë me rrethina ka vetëm 1000 ushtarë serbë, ndërsa në Malësi nuk ka më tepër se 500 ushtarë e dy topa<sup>16</sup>. Në këtë kuptim, konfiguracioni gjeografik Gjakovës me rrethina ia mundësonte Komitetit të MKK-së, që të kishte informacionin e nevojshëm (mjaftueshëm). Gjakova ndodhej gjeografikisht brenda trekëndëshit Shkodër-Prizren-Pejë. Si rezultat i kësaj, Komiteti MKK kishte aktivitet të theksuar kombëtar dhe jo vetëm, sepse ishte brenda një vendkryqëzimi të rrugëve tregtare dhe ushtarake me funksion aktiv.

Qazim Bakalli mbante lidhje të ngushta me Bajram Currin dhe Fan Nolin. Ai ishte mjaft aktiv, si në qytet, ashtu edhe në Malësinë e Gjakovës, e cila ishte një pikë mbështetjeje e fortë e Komitetit. Këtë e dëshmon më së miri një letër e Qazim Bakallit në emër të Komitetit të Gjakovës, drejtuar Z.B.B.P. në Malicë:

*“Tuj u mëshitet pikave të programit tonë, kena mujtë me ba marrveshtie me djelmnitë të disa qytetve të kësaj krahine b. f. Shkup, Prizrenët, Ferizoviq, Prishtinë, Pejë e Podrime (Rahovec), e me tjerat jena kah*

14 Shkëlzen Zajmi dhe Blerim Zajmi, *Familja Zajmi...*, f. 145.

15 Lush Culaj, *Komiteti “Mbrotjja Kombëtare e Kosovës” 1918-1924*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1997, f. 88.

16 Lush Culaj, *Një pyetje tepër dinake e Serbisë*, gazeta “Bujku”, Prishtinë, e shtunë, 25 prill 1998, f. 21.

*mundohemi me gjetë mjete për me u marrë vesh. Me gjithë këtë, shqypetarët janë nën kontrollin e shqyrtimit të rrastë të spjujve. Tregu për natë kthehet nga ushtritë e merren e grihen gjindja në mesnatë, plaçkiten rrugave për gjith ditë. Korospondenti i Ferizoviqit e aj i Prishtinës na lajmron, se në kta qytetet shqypetarët janë marrë nën strehim ushtarak, shumicën e të cilve po i çoin në Selanik. Prishtina i ka përbuzë kërkimet qeveritare për me çue deputet shqypetarët në Belegard”.*

Besnikëria e tij ndaj Komitetit MKK dëshmohej në një letër të datës 3 janar 1920, drejtuar nënprefekturës së Malësisë së Gjakovës në Krasniqe, me anën e së cilës e njoftonte mbi gjendjen politike të brendshme dhe të jashtme të vendit, pasi Gjakova dhe Malësia e saj si zonë kufitare ishin më të ekspozuara ndaj dhunës, terrorit dhe barbarive serbo-malazeze në krahasim me zonat e tjera të pushtuara, për shkak se në strukturën e saj etnike dominohej nga shqiptarët. Ai jepte udhëzime për popullarizimin e programit të Komitetit, ku ndër të tjera thuhet: “*Veproni me sa të mundeni kundër Cana Begut e në këtë pikë keni me bashkëpunue me Qazim Bakallin*”<sup>17</sup>.

Pas vrasjes së Bajram Currit, ai iu përkushtua veprimtarisë fetare në tarikatin bektashi<sup>18</sup>. Po ashtu, një bektashi i njohur si Aqif pashë Elbasani, qysh më 1914-n në fazat e hershme të fillimit të punës në Shkodër me ndërmjetësimin e Kadri Prishtinës, i cili kishte lidhje të ngushta me pashain e Elbasanit<sup>19</sup> u inkuadrua në organizimin e fshehtë për formimin e një Komiteti<sup>20</sup>, në të cilin do të përfshiheshin intelektualët e Shqipërisë, qëllimi i të cilit ishte ta shpenzonin energjinë e fundit për t’i kontribuar çështjes kombëtare<sup>21</sup>.

Më vonë, në pranverë të vitit 1919, drejtonte si kryetar degën e Elbasanit. Komiteti kishte si synim organizimin për realizimin e idesë kombëtare dhe krijimin e një shteti shqiptar, që do të krijonte një politikë

17 *Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar 1918-1920*, (Përmbledhje dokumentesh), vëllimi II, përgatitur nga Muin Çami dhe Hidajete Luga (Bejtja), Akademia e Shkencave: Instituti i Historisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit të RSH, Tiranë, 1976, f. 13.

18 Muhamet Shatri, *Të dhëna bioafjike mbi disa veprimtarë të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”*, Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (Përmbledhje kumtesash), botues: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë – Tiranë, Instituti i Historisë – Prishtinë, 2004, f. 166.

19 Behar Myftari dhe Serxhio Mazreku, *Pashai i Elbasanit*, Tiranë, “Onufri”, 2012, f. 9.

20 Lush Culaj, *Shkodra mbroren Kosovën, gazeta “Bujku”*, Prishtinë, e enjte, 23 prill 1998, f. 13.

21 Pas hyrjes së Malit të Zi në Shkodër, më 27 qeshor 1915, u ndalua veprimtaria e kësaj organizate, por programi dhe vultat e Komitetit u fshehën. Edhe në periudhën e Austro-Hungarisë puna e Komitetit mbeti në heshtje, pasi anëtarët e qendrës u shpërndanë.

dhe një udhëheqje unike edhe në qytete që gjendeshin brenda kufirit të Shqipërisë londineze. Kështu, hoxhë Kadri Prishtina i dërgon një letër Aqif Pashës, të cilën ia dha shoqërisë “Afërdita”. Ajo bënte fjalë për ndihmat që duhet të mblidheshin në Elbasan për nevojat e Komitetit. Pas bisedave në klubin e shoqërisë, u bënë ftesa tregtarëve të mëdhenj e të vegjël të qytetit dhe parisë së vendit, që pa përjashtim të vinin në atë klub. Aty Aqif Pasha u tregoi pse ishin mbledhur. Në fjalën e rastit ai preku ndjenjat e pjesëmarrësve, duke përmendur kontributin e kosovarëve për çështjen kombëtare. Pastaj filluan të regjistroheshin ata që jepnin ndihmat (shënohej emri, mbiemri dhe sasia që jepte secili). Gjithsej u mblodhën 70.000 lireta, që ishin baras me 3500 napolona ari. Këto para u dërguan në Shkodër me dy kalorës të Aqif Pashës. Në letrën shoqëruese i shkruanin Komitetit, që t’u dërgonte dhënësve të ndihmës një falënderim për të fituar besimin për herë tjetër. Dhe Komiteti ashtu veproi. Secilit i dërgoi falënderim po me ata kalorës<sup>22</sup>. Këto ndihma ishin të rëndësishme për Komitetin, pasi shenjat e shkatërrimit të pas Luftës Botërore ishin plotësisht të qarta, konflikti midis lëvizjes nacionale të shqiptarëve brenda territorit të Kosovës, mbretërisë së sapoformuar serbo-kroato-slllovene dhe pretendimeve të Fuqive të Mëdha, që në këtë kohë të mos shkaktonin konflikte me përmasa të gjera, ishte i dukshëm. Ndihmat u vlerësuan shumë pozitive në kushtet shoqërore-politike-ekonomike, dhe të marrëdhënieve ndër shqiptarët në këtë kohë të përpjekjeve për ringritjen e shteti shqiptar.

Aktiviteti i Komitetit që u zgjerua vullshëm në mbarim të vitit 1918, sidomos në vitet e mëvonshme, e kishte pasur bazën pikërisht në veprimtarinë ilegale të filluar qysh në maj të vitit 1918. Këtë na e vërteton edhe fakti se në mbarim të Luftës së Parë Botërore, kur filloi të vepronte legalisht Komiteti, kishte një strukturë e organizëm shumë më të plotë dhe të konsoliduar nga ç’mund të kishte një organizatë e sapoformuar<sup>23</sup>. Kështu, si një veprimtar brenda saj, ishte Beqir Vokshi si dhe të tjerë atdhetarë, pjesëmarrës në kryengritjet anti-osmane të vitit 1910-1912, po ashtu edhe gjatë pushtimit serbo-malazez<sup>24</sup>. Kontributin më të madh atdhetar Beqir Vokshi e dha së bashku me bashkëpunëtorët e tij të besueshëm, në grumbullimin e të dhënave mbi masakrat serbe që bëheshin mbi

22 *Aqif Pashë Elbasani (1860-1926)*, (Përmbledhje dokumentesh), Përgatitur nga: Mentar Belegu, Hysen Kordha dhe Rudina Mita, Tiranë, Bashkia Elbasan, 2012, f. 287.

23 Lush Culaj, “Shqipëri e lirë dhe veturdhëruese”, *Gazeta “Bujku”*, Prishtinë: E premtë, 24 prill 1998, f. 13.

24 Marenglen Verli, “*Nga Kosova për Kosovën profile biografike*”, Vëllimi i parë, Tiranë: Botimpex, 2006, f. 191.

popullsinë shqiptare si dhe përpiluan statistikat e përbërjes së popullsisë së Kosovës. Ai ishte shumë i kujdesshëm dhe dërgonte të dhëna të përpikta, të verifikuara në terren<sup>25</sup>, sepse Komiteti MKK kishte si qëllim mbledhjen e dërgimin në kryesinë e organizatës të statistikave të popullsisë dhe të vendbanimeve të saj, të protestave e promemorieve që u drejttoheshin përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha të kohës, personaliteteve shtetërore, njerëzve përparimtarë në vende të ndryshme etj<sup>26</sup>. Kështu, statistikat që iu dërguan Komitetit, të mbledhura nga Beqir Vokshi me bashkëpunëtorë, ndihmuan për të denoncuar para opinionit ndërkombëtar terrorin dhe dhunën e mbretërisë serbe-kroato-slllovene mbi shqiptarët e Kosovës.

Në janar të vitit 1919, në letrën drejtuar Komitetit, Beqir Vokshi njoftonte dërgimin e statistikave të Pejës e Gjakovës, si dha masat e marra për sigurimin e statistikave të Prishtinës, Mitrovicës dhe Vuçiternës. Po ashtu, dy muaj më pas, më 5 mars 1919, në një letër dërguar Komitetit, ai shprehet se preferon të qëndrojë aty ku ka qëndruar deri në atë kohë (d.m.th. në Gjakovë A.D.), duke kërkuar të sqarohet mbi situatën në mënyrë të hollësishme, pasi pas rënies së Plavës dhe Gucisë, mijëra refugjatë mbërritën në Malësinë e Gjakovës. Në një situatë të tillë, komandanti serb i Hasit, i shoqëruar nga një forcë ushtarake, erdhi në Bytyq dhe, pasi deklaroi se do të organizonte disa posta të detashmenteve ushtarake në katër vende të ndryshme të Malësisë së Gjakovës, urdhëroi që të gjithë kryetarët e Malësisë të vinin e të merreshin vesh me të. Duke qenë e qartë se forca ushtarake e Malësisë nuk qe në gjendje t'u rezistonte forcave ushtarake të Serbisë, 6 malësorë, të gjithë partizanë të Esat Pashës, nëpërmjet qeverisë serbe, u dërguan në Beograd. Këta persona nuk kishin madje as mandatin që të flisnin në emër të familjeve të tyre. Atyre u ishte thënë:

*“Ju lutem të bëni përpjekje pranë autoritetit të duhur, duke deklaruar se Serbia mund të hyjë në Malësinë e Gjakovës vetëm me pushkë dhe topa dhe kundër vullnetit të popullsisë. Ka shumë të ngjarë që serbët do të formojnë një qeveri serbe në Malësi dhe këto dy ditë të gjithë kryetarët e malësorëve do të braktisin vatrat e tyre, sepse Serbia do t'i pushtojë ata”<sup>27</sup>.*

25 Shevqet S. Canahasi, “Pishtari i arsimit e i demokracisë Niman Ferzizi (1883-6 korrik 1937)”, Shoqata e intelektualëve “Jakova”, Gjakovë, 2015, f. 177.

26 Zamir Shtylla, “Rreth krijimit e veprimtarisë së Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” në vitet 1918-1920”, *Studime historike*, Tiranë: Akademia e Shkencave e RSH:Instituti i Historisë, Viti XXXX (XXIII), Nr.3, 1986, f. 106.

27 *Gjeneral G. F. Phillips dhe Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”*, dokumente historike nga arkivat britanike 1913-1921, përgatitur nga Ethem Çeku dhe Bejtullah Destani, Tiranë dhe

Ndërsa në shkurt të vitit 1921, Beqir Vokshi njoftonte Bajram Currin për statistikën e Krasniqit, Gashit, Bytyqit, Tropojës, Nikajit e Mërturit. Për këto arsye Komiteti MKK statistikën e Beqir Vokshit i përktheu në gjuhën frënge, në mënyrë që t'i dërgoheshin Konferencës së Versajës dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare. Kjo bëhej me qëllim që çështja e drejtë shqiptare të mbrohej me fakte të gjalla e prova bindëse kundrejt politikës shoviniste antishqiptare të gjenocidit e shfarosjes në masë të serbëve, të grabitjes së paskrupullt të tokave me anë të së ashtuquajturës reformë agrare kolonizuese dhe shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve prej qarqeve të Beogradit.

Ai informonte rregullisht dhe me saktësi situatën në Gjakovë dhe në krahinat e tjera të Kosovës. Në raportin dërguar Komitetit në mars të vitit 1920 nga Gjakova, ai vë në dijeni gjendjen jo vetëm në Rekë, Pejë e Gjakovë, por edhe veprimtarinë e komiteteve rajonale të Podgurit, Drenicës, Rugovës dhe Istogut<sup>28</sup>. Kontributi i tij i ndihmoi Komitetit, që në vijimësi me anë të letrave, peticioneve, memorandumeve, kontakteve të drejtpërdrejta, artikujve të botuar, informoi qeveri, politikanë, individë të dalluar, shoqatave ndërkombëtare-qeveritare dhe joqeveritare, vetë Konferencën e Paqes dhe Lidhjen e Kombeve me pozitën e njëmendtë të shqiptarëve në Jugosllavi<sup>29</sup>.

Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” ishte një organizatë politike gjithëkombëtare, që kishte luftuar për mbrojtjen e trojeve dhe të interesave të mbarë popullit dhe bënte thirrje që t'i tregohesh botës, *“se kombi shqiptar, pa ndërlikim feje e besimesh, me ndihmën e mendimtarëve që do ta përkrahin, bashkë me fuqitë intelektuale të këtij kombi, dora-dorës me ata që kishin një kulturë, u munduan pa u lodhur dhe pa përtesë”*<sup>30</sup>. I tillë ishte intelektual, mësuesi dhe anëtar i teqesë së rifa'i, Ibrahim Fehmiu. Në vitet 1916-1918, gjatë Luftës së Parë Botërore, ai iu përkushtua çështjes edukativo-arsimore. Pas vitit 1918, Ibrahim Fehmiu si shumë atdhetarë të tjerë, u detyrua të largohej drejt Shqipërisë<sup>31</sup>. Ai dha një kontribut të çmuar në

---

Londër, Instituti i Çështjeve Kombëtare, Qendra për Studime Shqiptare, 2015, f. 312-313.

28 Alban Dobruna, *Beqir Vokshi dhe “Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”*, Kosova, Instituti i Historisë-Prishtinë, Nr. 35/36, 2012, f. 335.

29 Emine Arifi-Bakalli, *Përpjekje e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” për denoncimin e dhunës dhe mbrojtjen e të drejtave kombëtare e demokratike të shqiptarëve në Jugosllavi*, Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (Përmbledhje kumtesash), botues: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë-Tiranë dhe Instituti i Historisë-Prishtinë, Tiranë, 2004, f. 34.

30 Hakif Bajrami, *Ibrahim Gjakova shtyllë e Komitetit të Kosovës*, “Vatra”, Prishtinë, 2000, f. 36.

31 Mexhid Yveysi, *101 personalitete fetare-atdhetare, kulturore-letrare*, Instituti për shkencat humane “Ibni Sina”, Prishtinë, 2013, f. 201.



administratë, arsimim dhe edukim, por edhe si veprimtar dhe aktivist brenda Komitetit MKK. U dallua në unitetin e nismave dhe aksioneve, duke nxitur dhe orientuar njëkohësisht veprimin e shqiptarëve si dhe unitetin në ndërmarrjen e aksioneve të përbashkëta për ruajtjen e tokave ku jetonin shqiptarët.

Në kohën që Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” po luftonte me të gjitha mjetet, si në rrafshin politik, ashtu edhe atë ushtarak e diplomatik<sup>32</sup>, aktivistë brenda saj, si bektashiu Hamdi Zajmi, ndihmuan në forma të ndryshme Komitetin. I tillë ishte rasti gjatë marsit të vitit 1919, kur Hamdi Zajmi mbështeti tubimin dhe mbledhjen e nënshkrimeve në Kosovë të pjesës dërrmuese të popullit, në mënyrë që të kuptohej përcaktimi i tyre për ardhmërinë e Shqipërisë. Në lidhje me këto nënshkrime u bënë shumë manipulime nga Serbia dhe bashkëpunëtorët e saj, gjë që bëri që gazeta “Populli” të publikonte shumicën nga intrigat që bëheshin. Ajo nxori në pah cila ishte e vërteta për çdo veprim që bënte Komiteti<sup>33</sup>. Në Krumë, në këtë kohë themelohet shoqëria kulturore-arsimore “Shkëlzeni”. Në themelimin e kësaj shoqërie morën pjesë edhe anëtarët e Komitetit MKK, Hamdi Zajmi dhe Niman Ferizi<sup>34</sup>.

Kjo dëshmon se pjesëtarët e tarikateve përpara çdo ngjarjeje të rëndësishme dhe sfidave që i dolën përpara Komitetit MKK, ishin të bindur se shpëtimi i atdheut mund të arrihet nëpërmjet vullnetit dhe me forca të përbashkëta. Ata iu përgjigjën thirrjes së kombit, me të cilin lavdërohen që janë të lidhur, dhe pritën nga çdo individ që ishte pjesë e tyre, të kryente shërbimin që mundej.

32 Hakif Bajrami, *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” dhe qeveritë e Tiranës për krimet serbe ndaj shqiptarëve 1918-1941*, Prishtinë, 2008, f. 4.

33 Shkelzen Zajmi dhe Blerim Zajmi, “Familja Zajmi..”, f. 149.

34 Sulltane Kojqini-Ukaj, *Kontributi i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” në arsimimin e kosovarëve, Kosova*, Instituti i Historisë-Prishtinë, Nr. 35/36, 2012, f. 275.